



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:097792
Datë: 07.02.2024
Numri i dokumentit: 05296232

CAP.nr.1580/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike sh.a. (Kesco), me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Clinton”, nr.5, ndaj debitorit A.H., nga fshati R....., Komuna e Rahovecit, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, PPP.nr.20/2021 të datës 15.02.2023, më datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e themeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike sh.a. (Kesco), me seli në Prishtinë, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, PPP.nr.20/21 të datës 15.02.2023 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.20/21 të datës 15.02.2023, në pikën një të dispozitivit ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbarim të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a në Prishtinë, kundër debitorit A.H., nga fshati R....., Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike përmbarimore. Në pikën dy, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij vendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet

ankesa e kreditorit, të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbardim ose të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, ashtu që në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbardimore si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbardim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve komunale për konsumimin e energjisë elektrike DGj-XXXXX, lidhur me borxhin në vlerë prej 493.53 euro, për periudhën kohore nga data 25.02.2020 e deri me datë 11.02.2021. Përmbarduesi privat, ka lejuar përmbardimin e kërkuar me urdhrin përmbardimor P.nr.XX/21 të datës 22.03.2021, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datë 31.03.2021, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 07.04.2021. Gjykata e shkallës së parë me konkluzionin PPP.nr.20/21 të datës 15.11.2022, ka urdhëruar kreditorin që në afat prej 3 ditësh të përmirësoj propozimin për përmbardim në definimin e saktë të lartësisë së borxhit si dhe periudhën kohore brenda të cilës pretendohet se është krijuar borxhi duke bashkëngjitur ekstraktin nga librat afarist, me njoftimin lidhur me pasojat ligjore në rast të mos veprimt. Kreditori, ka pranuar konkluzionin me datën 23.11.2022, ndërsa nuk ka vepruar sipas udhëzimeve. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, mos përgjigjes së kreditorit sipas konkluzionit, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n), të LPK-së, lidhur me nenin 38 të LPP-së.

Aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet meqë dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten si dhe me arsyetimin e aktvendimit, në aktvendimin e atakuar ekzistojnë fakte vendimtare në kundërtënie midis asaj që në hyrje dhe dispozitiv të aktvendimit thuhet për përmbajtje të dokumentit. Gjykata e shkallës së parë në hyrje, dispozitiv dhe arsyetim të aktvendimit të atakuar ka shënuar si debitor Korporata Energjetike e Kosovës KEK, ndërsa në bazë të propozimit për përmbardim si kreditor është Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike sh.a. (Kesco), jo sikur është shënuar në aktvendimin e atakuar.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 38 të LPP-së, ku është përcaktuar se: *“Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimt apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet*

të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit". Në rastin konkret gjykata ka bërë shkelje kur me anë të konkluzionit ka ftuar kreditorin që të bëjë plotësimin e propozimit për përmbarim sa i përket lartësisë së borxhit dhe periudhës për të cilën kërkohet borxhit, pasi që propozimi për përmbarim i përmban të gjitha elementet e kërkuara sipas dispozitës së lartcekur dhe se gjykata është dashur që të vendos lidhur me borxhin e kërkuar për përuhdën e cekur në propozim për përmbarim, duke marr parasysh edhe pretendimet e palëve të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim. Andaj, në bazë të cekurave aktvendimi i atakuar u deshtë që të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të vlerësoj propozimin për përmbarim sa i përket lartësisë së borxhit dhe periudhës, të vlerësoj pretendimet e paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, në rast të paqartësive të caktoj seancë dëgjimore konform nenit 73 të LPP-së, të vlerësoj pretendimin nëse ekziston parashkrimi apo jo, e pas kësaj të vazhdoj procedurën konform dispozitave ligjore duke marr aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209 pika d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1580/2023, më datë 07.02.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti